



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3787/5 Prot.

Pogradec, më 29.09.2023

VENDIM

NR. 104, DATË 27.09.2023

**“PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË STREHIMIT PËR VITIN USHTRIMOR 2023-2024 SIPAS
LIGJIT NR. 22/2018 ME DISA NDRYSHIME ME LIGJIN NR. 48/2023 DATE 22.06.2023”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenit 2, pika 51 dhe nenit 15, pika 5, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

KËSHILLI BASHKIAK

1. Pranë Bashkisë së Pogradecit ngrihet dhe funksionon Komisioni i Strehimit.
2. Komisioni i Strehimit shqyrton dhe merr vendime në lidhje me kërkesat e paraqitura nga çdo subjekt që kërkon për të përfituar nga njëri prej programeve sociale të strehimit, si dhe për çdo çështje tjetër që parashikohet nga legjislacioni për strehimin, çështjet sociale apo nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë shqyrtimin e kërkesave nga ky komision.
3. Komisioni i Strehimit përbëhet nga 7 anëtarë, si më poshtë:

1) Nënkryetar i Bashkisë Pogradec	(Paskalino Ziko)	Kryetar
2) Drejtor i Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokave Bujqësore në Njësitë Administrative	(Besmira Niko)	Anëtar
3) Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale	(Ivana Llakmani)	Anëtar
4) Përfaqësues i Shoqatës së Invalidëve	(Dritan Balliu)	Anëtar
5) Përfaqësues i Komuniteteve të Interesuara (Rome/Egjyptiane)	(Shpëtim Dute)	Anëtar
6) Anëtar i Këshillit Bashkiak	(Arbër Male)	Anëtar
7) Anëtar i Këshillit Bashkiak	(Vjollca Pllaha)	Anëtar
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (Sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”).

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

